

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rritja e frikshme e AfD-së/ Pse demokracia gjermane s'mund të mbrohet më nga ekstremizmi?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/rritja-e-frikshme-e-afd-se-pse-demokracia-gjermane-smund-te-mbrohet-me-nga--i586278
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:38:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cdcc37a7fc5275eca365847f9d23e4e98005ba314b6296668df35f6a5fba7890
TEKSTI	8f08ed9f4bd4d8dece60f08afb9f913d8bfa1cf97c115e00e566b3ca9989d0e6d
PAMJA	60555fd86184c4a9bdc3c2cd1b589cdfdf3cd30d63bb8fa19e55df767cc843f2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	efffb48be707cf204f2c35181695eabc39310a9a41fc57bdf9f8c2897896821
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/efffb48be707cf204f2c35181695eabc39310a9a41fc57bdf9f8c2897896821>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie Rritja e frikshme e AfD-së/ Pse demokracia gjermane s'mund të mbrohet me nga ekstremizmi? Të terrori që vetëm Pëpin mund ta shohë Ndalet nga jeta në moshën 88-vje fundit

Rritja e frikshme e AfD-së/ Pse demokracia gjermane s'mund të mbrohet më nga ekstremizmi?



15 Shtator 2026, 15:35 Bota TEMA



Rritja e pandalshme e partisë së djathtë ekstreme Alternativa për Gjermaninë (AfD) po e çon sistemin politik gjerman drejt një sprove të paprecedentë, ku koncepti tradicional i murit mbrojtës politik, i njohur si *Brandmauer*, po përballlet me erozion dhe shkatërrimin e tij të plotë.

Ky mur politik nuk është një ligj i shkruar, por një marrëveshje joformale e hekurt midis partive kryesore për të mos bashkëpunuar kurrë, për të mos formuar koalicione dhe për të mos u mbështetur tek votat e AfD-së për të krijuar shumicën qeverisëse.

Megjithatë, rezultatet e fundit elektorale në krahinat e Gjermanisë Lindore si në Saksoni-Anhalt, ku AfD ka arritur të marrë pothuajse 44% të votave, treguan se ky izolim procedural po dështon në mënyrë përfundimtare përballë një mbështetjeje popullore që është dyfishuar me shpejtësi gjatë viteve të fundit.

Gabimi më i madh strategjik i partive të qendrës, veçanërisht i Demokristianëve (CDU), ka qenë përqendrimi obsesiv te mekanizmat e mbrojtjes pasive institucionale dhe te procedurat e izolimit, në vend të hartimit të një ofensive politike me zgjidhje konkrete, që u përgjigjet shqetësimeve të përditshme të qytetarëve.

Arsyeja pse njerëzit po e votojnë AfD-në nuk është thjesht një kthim i papritur drejt ideologjive radikale, por një ndjenjë e thellë braktisjeje ekonomike dhe sociale. Rajone të tëra në lindje, por tashtë edhe qendra të mëdha industriale në perëndim si Baden-Urtemberg, po përballen me një deindustrializim të rëndë, mbyllje fabrikash, humbje të dhjetëra mijëra vendeve të punës në sektorin e automobilave, rënie demografike dhe një rritje të pasigurisë për të ardhmen.

Kjo shpëputje e elitave politike në Berlin nga realiteti i vështirë i qytetarëve prodhoi një efekt anësor plotësisht paradoksal: muri mbrojtës u dha radikalëve të AfD-së statusin e privilegjuar të opozitarit të vetëm, disidentit të vetëm anti-sistem dhe mbrojtësit të të pakënaqurve, pa u ngarkuar asnjëherë me përgjegjësinë apo llogaridhënien në qeverisje.

Në të njëjtën kohë, përpjekjet e dëshpëruara të partive tradicionale për të kontrolluar këtë valë pakënaqësie duke kopjuar apo huazuar retorikën e ashpër të AfD-së mbi emigracionin apo duke propozuar ndalimin e saj përmes rrugëve gjyqësore po rezultojnë krejtësisht të pafrytshme.

Studimet elektorale tregojnë qartë se sa herë që partitë e qendrës imitojnë agjendën e së djathtës radikale, ato nuk ia marrin votuesit asaj, por thjesht u japin

më shumë legjitimitet ideve të saj, duke i shtyrë njerëzit të votojnë origjinalin dhe jo imituesit.

Kriza politike gjermane dëshmon se një mur mbrojtës apo një procedurë ligjore mund ta ruajë një strukturë shtetërore vetëm përkohësisht.

Asnjë mekanizëm juridik nuk mund ta zëvendësojë nevojën për një vizion bindës qeverisës që zgjidh punësimin, sigurinë e jetesën dhe u dëshmon qytetarëve me vepra se pse demokracia mbetet ende sistemi më i mirë për të ardhmen e tyre.

[Analizë nga Joshua Yaffa, The New Yorker](#)

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Makina përplasët me këmbësorët dhe dy automjete, dy të vdekur dhe katër të plagosur rëndë në Britani

14:05 Bota / 2 komente

Dyshohet për sabotim/ Kaos në hekurudhat e Holandës, anulohet qarkullimi i trenave

13:25 Bota

Marrja e kontrollit të Ngushticës Bab el-Mandab nga Huthit, OKB njofton mbledhje urgjente të Këshillit të Sigurisë

13:15 Bota

Europa nuk e di më çfarë është

12:27 Bota /4 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.